



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2022

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 02/11/2022

Drejtuar: OE “MCE” SH.P.K dhe adrese Rruga “Kavajës”, Qendra “Sun Tower”, Kati 9, Ap. 38, Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: “E Hapur e thjeshtuar”/ “Sherbime”.

Numri i procedurës/ referenca e Lotit: REF-45650-10-12-2022.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane ne territorin e Bashkise Lezhe”.

Kohëzgjatja e kontratës: 36 muaj nga data e nenshkrimit te marreveshjes kuader.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “MCE” SH.P.K, me Nuis L72203065K dhe me oferte ekonomike 1,510,177.86 (njemilion e peseqind e dhjete mije e njeqind e shtatedhjete e shtate pike tetedhjete e gjashte) Lek pa TVSH),
2. Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” SH.P.K, me Nuis L01717030C dhe me oferte ekonomike 1,546,869.12 (nje milion e peseqind e dyzet e gjashte mije e teteqind e gjashtedhjete e nente pike dymbedhjete) Lek pa TVSH,

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO”SH.P.K, me Nuis L01717030C,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson piken 2.3.4 ku parashikohet se “Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij, dhe të figurojnë në licencën e shqërisë (Drejtues teknik) përsonele si më poshtë:

- a. *Inxhinier Ndërtimi* **1 (nje)**
- b. *Inxhinier Mjedisi* **1 (nje)**
- c. *Inxhinier Gjeodet* **1 (nje)**

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale personale të mbikëqyrjes, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Qershor 2022 - Gusht 2022. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatëse.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit”.

KVO verën se bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për të permbushur këto kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetedeklarojnë në formularin permbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatëse të DST-se, të dhënat e stafit e mbështetës që disponon sipas përcaktimeve të mesipërme.*

Nga verifikimi i formularit permbledhës të vetedeklarimit, rezultojnë se ky OE ka deklaruar disponimin e 1 (nje) inxhinier mjedisi, Zj. Silvana Hila, por nga verifikimi i dokumentacionit bashkëngjitur në SPE vërehet se kjo e fundit është diplomuar në degën “Kimi Industriale”, si “Kimi i Teknologjës” pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës. KVO gjykon se megjithatë ky OE ka deklaruar në formularin permbledhës të vetedeklarimit disponimin e një inxhinier mjedisi, si dhe duke qenë se ka bashkëngjitur në SPE diplomën e Zj. Silvana Hila, vërehet se OE nuk ka pasur si qëllim për të bërë deklarament të rreme me qëllim kualifikimi.

Theksojmë se për të permbushur pikën 2.3.4, OE-te, në lidhje me disponueshmërinë e një inxhinieri mjedisi duhet që një nga drejtuesit teknik të jetë i pajisur me diplomë për inxhinieri mjedisi të lëshuar nga një Fakultet Inxhinierik i cili ka program studimi për Inxhinieri Mjedisi.

Rrjedhimisht një drejtues teknik i diplomuar si Kimist-Teknolog nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3.4, të DST-se pasi nuk disponon diplomë universitare si Inxhinier Mjedisi.

Se dyti, nuk plotëson pikën 2.3.5 ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto çertifikata në përputhje me objektin e prokurimit:*

- Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një çertifikatë ISO 9001 : 2015 të vlefshme ose ekuivalent.

- *Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një certifikatë ISO 14001: 2015 të vlefshme ose ekuivalent.*
- *Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një certifikatë ISO 45001:2018 të vlefshme ose ekuivalent”.*

Theksojme se për të përmbushur pikën 2.3.5, Operatorët ekonomike duhet të paraqesin një certifikatë ISO 9001 : 2015 ose ekuivalente, një certifikatë ISO 14001: 2015 ose ekuivalente dhe një certifikatë ISO 45001:2018 ose ekuivalent”.

Nga verifikimi në SPE, rezulton se Operatori Ekonomik ka paraqitur vetëm certifikatën ISO 9001: 2015, ndërsa nuk ka paraqitur asnjë dokument që provon disponimin e certifikatës ISO 14001: 2015 si dhe disponimin e certifikatës ISO 45001:2018 duke mos përmbushur këto kriter.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nën 76, pika 3/a dhe nën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar nën 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “NOVATECH STUDIO” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” SH.P.K, me Nuis L01717030C, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “MCE” SH.P.K, me adrese Rruga “Kavajës”, Qendra “Sun Tower”, Kati 9, Ap. 38, Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,510,177.86 (njemilion e peseqind e dhjete mije e njeqind e shtatedhjete e shtate pike tetedhjete e gjashte) Lek pa TVSH) është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI
Pjerin NDREU

